# KARTELA SHOQERUESE E DOKUMENTIT

DERGUESI: Muca Auditing

NR.PROT. I DERGUESIT__________ DATA E DOK 24.03.2023

NR.PROT. I U.P: 148 DATA E MBERRITJES NE U.P 29.03.2023

LENDA: Auditimi i Pasqyrave Financiare

SHENIM: ______________________________________________

______________________________________________

# O.J.F “URDHRI I PSIKOLOGUT” TIRANE

## AUDITIMI I PASQYRAVE FINANCIARE

## PËR

## PERIUDHËN

## 1 JANAR - 31 DHJETOR 2022

Tiranë , 24 MARS 2023

*"Muca Auditing"sh.p.k*
*NUIS L81406044I,*
*Cel. 069 4092435,*
*e-mail : mucalindita@yahoo.com*

# RAPORTI

# I

# EKSPERTIT KONTABËL TË REGJISTRUAR

**Mbi Auditimin e Pasqyrave Financiare të vitit ushtrimor 2022**
**të** O.J.F "URDHRI I PSIKOLOGUT" **TIRANE**

Drejtuar : **Znj, Valbona Treska Perfaqesues Ligjor i** O.J.F "URDHRI I PSIKOLOGUT""

**TIRANE**

Kemi audituar Pasqyrat Financiare bashkëlidhur të Shoqërisë "O.J.F "URDHRI I PSIKOLOGUT"" , të cilat përmbajnë : **B**ilancin kontabël, **P**asqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve, **P**asqyrën e Flukseve Monetare (Cash Flow), **P**asqyrën e levizjes së kapitaleve dhe **S**hënimet shpjeguese për ushtrimin e mbyllur më datë 31 Dhjetor 2022.

Përgatitja dhe paraqitja e sinqertë e këtyre pasqyrave financiare në përputhje me Standartet e raportimit financiar është përgjegjësi e Drejtimit të shoqërisë. Kjo përgjegjësi përfshin : hartimin, vënien në zbatim dhe mbajtjen e kontrollit të brendëshëm të përshtatshëm për përgatitjen dhe paraqitjen me sinqeritet të pasqyrave financiare që ato të mos përmbajnë anomali materiale për shkak të mashtrimit apo gabimit, zgjedhjen dhe zbatimin e metodave të përshtatshme kontabël si dhe çmuarje kontabël të arsyeshme për rrethana të dhëna.

Përgjegjesia jonë është që, bazuar në auditimin e kryer, të shprehim një opinion mbi këto pasqyra financiare.
Kemi kryer auditimin në pajtim me Standartet Ndërkombëtare të Auditimit.
Këto standarte kërkojnë që në procesin e auditimit të zbatohen kërkesat etike dhe auditimi të planifikohet dhe të kryhet për të marrë sigurinë e arsyeshme që pasqyrat financiare nuk përmbajne anomali materiale.

Auditimi përfshin ekzaminimin, mbi bazën e testeve, të evidencës që mbështetet në shumat dhe informacionet e dhëna në pasqyrat financiare. Procedurat e zgjedhura varen prej gjykimit të audituesit duke përfshirë vleresimin e rreziqeve

për anomali materiale në pasqyrat financiare për shkak të mashtrimit apo gabimit. Në përcaktimin e vlerësimeve të rrezikut auditusi merr në konsideratë kontrollin e brendëshëm të shoqërisë në mënyre që të hartojë procedurat e auditimit të përshtatshme për rrethanat, por jo me qëllim të shprehjes së opinionit për efektivitetin e kontrollit të brendëshëm të shoqërisë.

Auditimi përfshin gjithashtu, vlerësimin e parimeve kontabël të përdorura dhe llogjikën e çmuarjeve të rëndësishme të bëra nga Drejtimi, si dhe vlerësimin e paraqitjes së përgjithëshme të Pasqyrave Financiare.

Besojmë se evidenca e auditimit e marrë është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë bazat e opinionit të auditimit.

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare të përgatitura me një besueshmëri të arësyeshme japin një pamje të vërtetë dhe të sinqertë për gjëndjet financiare të Shoqërisë "O.J.F "URDHRI I PSIKOLOGUT"", më 31 Dhjetor 2022, *t*ë rezultatit financiar, *t*ë levizjes monetare (flukseve të parasë) dhe *t*e levizjes se kapitaleve në pajtim me Ligjin Nr. 9901 datë 14.04.2008 "Për Tregëtarët dhe Shoqëritë Tregtare", Ligjin Nr.25 date, 10.05.2018 "Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare" ne perputhje me Standartet Kombëtare të Kontabilitetit .

**Lindita Muça**

**Tirane,24.03.2023** ***Auditues Ligjor(EKR)***